

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "KAMI" Sh.p.k.

Sot më datë 01.01.2018,

1. Z.Fundim Selman Gjepali, qytetar shqiptar, mbajtës i dokumentit të identifikimit letërnjoftim me Nr.personal I11206004K ,
2. Z.Selman Elez Gjepali, qytetar shqiptar, mbajtës i dokumentit të identifikimit pasaporte me nr. BD0484743, nr Personal E21108065S

ka vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "KAMI" Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Gjepalaj e poshtëme, Njësia Administrative Gjepalaj, Shijak, Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një afat te pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- 4.1 Aktivitete te agroturizmit dhe zhvillim rural, restoranti dhe të ngjashme; merr, trajton, ruan, magazinon, prodhon, perpunon, tregton, blen, shet ose merret me çdo menyre a mjet tjeter me produkte bujqesore. Të ushtrojë aktivitet në fushën e përpunimit, ambalazhimit, marketimit dhe tregëtimit të produkteve blegtorale, bujqesore, shtazore dhe të gjitha derivateve të tyre dhe te kryeje çdo veprim tjeter qe lidhet me prodhimin, perpunimin dhe tregtimin ne fushen e produkteve bujqesore dhe blegtorale ne teresi, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.
- 4.2 Shoqeria ka te drejte te mundesoje trajnime profesionale për palet e treta, te kryeje çdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhenie-marrje me qira, te vendose pengje dhe barre hipotekore qe mund te konsiderohen si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise.
- 4.3 Mbarështimi blegtorial të imta dhe të trasha, mbarështim dhe prodhim bletësh. Prodhim, shitje, import-eksport të prodhimeve blegtoriale si mish, bulmet, mjaltë,



etj. 4- Grumbullim, shitje import- eksport të bimëve dhe frutave natyrale mjeksore dhe përpunimin e tyre në barna popullore, etj.

- 4.4 Të ushtrojë aktivitet trajnues në fushat e mësipërme dhe në fushën e promovimit territorial dhe zhvillimit të qëndrueshëm; Të kryejë çdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin, Të zoterojë kuota/aksione apo çdo lloj interesi tjetër në shoqëri të tjera, pavarësisht fushës në të cilën kryejnë veprimtari këto shoqëri. Të kryejë çdo veprim tjetër në përmbushje të interesave dhe nevojave të shoqërisë dhe sipas dispozitave të statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë.
- 5.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota.

Neni 6 - Kontributet

- 6.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar nga Z.Fundim Gjepali, qytetar shqiptar, mbajtës i dokumentit të identifikimit letërnjoftim me Nr.personal I11206004K , në një kuotë të barabartë prej 60 % dhe Z.Selman Gjepali, qytetar shqiptar, mbajtës i dokumentit të identifikimit pasaporte me nr. BD0484743, nr Personal E21108065S në një kuotë të barabartë prej 40 % në favor të shoqërisë në themelimin e sipër “KAMI” Sh.p.k.
- 6.2. Sipas kontributit të mësipërm:
Z.Fundim Gjepali i përket 1 kuotë e barabartë me 60 lekë ose 60% (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, dhe
Z.Selman Gjepali i përket 1 kuotë e barabartë me 40 lekë ose 40% (dyzetë përqind)

Neni 7 – Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administratori

- 8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Vetëm i Shoqërisë personi i mëposhtëm:

z.Fundim Gjepali, mbajtës i dokumentit të identifikimit letërnjoftim me Nr.personal I11206004K, i cili ka të drejtë të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 8.2 Administratorit të Vetëm i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori i Vetëm, mund t'i drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund t'i delegojë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.




- 8.3 Administratori i Vetëm është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj pranë regjistrimit tregtar si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Fundim Gjepali

Fundim Gjepali 

Selman Gjepali

SELMAN GJEPALI 

Tiranë, më 01.01.2018

Aplikanti: ~~Agim Selmi~~ Selmi